

Detyrat për strukturat komunitare në fshat:

Në Bashkinë tonë janë krijuar strukturat komunitare në fshat dhe në Qytet. Çdo fshat drejtohet nga kryetari i fshatit dhe kryesia. Kryesia e fshatit është organi këshillimor i kryetarit. Anëtarët e kryesisë së fshatit janë zgjidhur me mbledhje në çdo fshat kanë marrë pjesë ma shumë se gjysma e banorëve me të drejte vote. Mënyra dhe rregullat e votimit janë të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak në bazë të nurmit të banorëve të fshatit janë përcaktuar numri i anëtarëve të kryesisë së çdo fshati.

Zgjedhjet e kryesisë së fshatit janë bërë në vitin 2023 menjëherë pas zgjedhjeve të keshillit bashkiak.

Kryetari dhe kryesia e fshatit kryejnë dhe mbështesin funksionet vetëqeverisëse vendore në fshatin e tyre si dhe kujdesen për zhvillim ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale.

Bazuar në vendimin e Kryetarit të bashkisë , kryestari ose kryesia e fshatit mund të kryeje detyrat si më poshtë:

- a. Kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara, si dhe rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit.
- b. Kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe çdo lloj dëmtimi të rrugëve, trotuarëve dhe shesheve publike në fshat.
- c. Administrimin e varrezave të fshatit
- d. Kujdesjen për ruajtjen e pyjeve dhe kullotave , si dhe të burimeve natyrore.

Detyrat më të hollësishme të tyre janë përcaktuar në ligjin 139/2015.

Kryetarët e fshatit ose qytetit janë të pajisur me vulë dhe kanë autoritetin të lëshojnë vertetime për fakte e të dhëna për banorët në territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët ose nga çdo institucion tjetër në përputhje me ligjin. Urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e organeve të zgjedhura të bashkise janë të detyrueshme për tu zbatuar nga kryetari dhe kryesia e fshatit.